



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:137709
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485399

Ac.nr.3145/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feak - Kryetar i kolegjit, Frosina Sylejamni dhe Arsim Hamzaj , anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit, B. K. e S. me seli në P., të cilin e përfaqëson Kompania C. LLC – i autorizuari L. K., kundër të paditurit B. B. nga fshatin S., të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Q.H., me padi për rimbursim të dëmit me vlerë, 28.375,90 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.223/15, i datës 04.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurit B. B. nga fshatin S./Komuna e S., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.223/15 i datës 04.04.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.223/15, të datës 04.04.2022 ka vendosur si në vijim:

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. K. e S.

II.OBLIGOHET i padituri B. B. që paditësit ti kompensoi shumën prej 28.375,90 euro në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut me datën 31.07.2006 në Ferizaj me kamat ligjore në lartësi prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

III. Në emër të shpenzimeve për taks gjyqësore shumë prej 142 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për vendimin për shpenzimet procedurale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pathemeltë apo që të priset aktgjykimi dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Paditësja, nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit B. B. nga fshati S./Komuna e S., është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, B. K. e S. përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 26.06.2015 ka ushtruar padi për rimbursim dëmi ndaj të paditurit B. B. me çka ka kërkuar që të detyrohet i padituri t'ia rimbursoi dëmin në shumë prej 28.375,90 euro me kamat ligjore dhe me shpenzimet e procedurës kontestimore. Paditësja ka theksuar se përmes Aktgjykimit C.nr. 584/06 të Gjykatës Komunale në Ferizaj të datës 14.02.2011 është obliguar ti kompensoi dëmin të dëmtuarit M. N. nga fshati Ll. për dëmin jo material dhe material të pësuar në aksident të komunikacionit ku fajtor ishte i padituri. Ky aktgjykim është ekzekutuar me urdhrin përmbartimor nr. 531/14 të datës 25.03.2015 dhe shuma prej 28.375,90 euro është transferuar nga llogaria e Bankës Ekonomike SH. A. në Prishtinë në llogari të përmbartuesit privat Fadil Hoxha në TEB bankë, për çka edhe kërkon të rimbursohet.

I padituri, përmes përgjigjes në padi të datës 11.07.2018 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me pretendimin se kërkesa është parashkruar nga se aksidenti ka ndodhur në vitin 2006 ndërsa padija ne këtë gjykatë është ushtruar në vitin 2015, për çka edhe është përfshire me parashkrim të kërkesës sipas nenit 357 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, ku thuhet se kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për 3 vite nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe personi i cili ka shkaktuar dëmin, por në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për 5 vite nga shkaktimi i demit. Sipas nenit 362 paragrafi 3 te LMD kërkesat e sigurimit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tri vite. Nuk është kontestuese se paditësi ka qenë ne dijeni për dëmin e shkaktuar nga data 03.10.2006, kur është ngritur padija për kompensimin e dëmit në Gjykatën Themelore në Ferizaj nga i dëmtuari M. N., e po ashtu paditësi ka qenë në dijeni edhe sipas aktgjykimit të datës 14.02.2011, ndërsa padinë nuk e ka ngritur deri me datën 26.06.2015, pra pasi qe kanë kaluar më shume se tri vite. I Padituri propozon që kërkesëpadia të refuzohet por nëse eventualisht gjykata gjen se kërkesa nuk është parashkruar atëherë i fal besimin mendimit dhe konstatimit të ekspertit H.L. të datës

30.10.2006, e jo ekspertizës së ekspertit N. D. të datës 28.02.2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.223/15 të datës 04.04.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se paditësi sipas Aktgjykimit C.nr. 584/06 të datës 14.02.2011 të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit CA.nr. 2404/12 të datës 06.08.2014 është detyruar që të dëmtuarit M. N. nga F. për aksidentin e datës 31.07.2006 ti kompensoi dëmin material dhe jo material si dhe shpenzimeve të procedurës në shumën 28.375.90 euro. Paditësi sipas urdhrin përmbarimor P.nr. 325/14 me datë 25.03.2015 nga Banka Ekonomike sh.a në Prishtinë ka paguar në emër të dëmit dhe transferuar në llogarinë e përmbaruesit privat Fadil Hoxha shumën prej 28.375,90 euro. Paditësi, nga ky moment kur është bërë pagesa me datë 25.03.2015 ka fituar të drejtën që të kërkojë ri mbursimin e dëmit të kompensuar të dëmtuarit nga këtu i padituri konform nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018, ku është përcaktuar se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, andaj edhe rrjedha e afatit të parashkrimit të drejtës për ri mbursim fillon nga ky moment. Paditësja për deri sa nuk ka paguar kurrfarë kompensimi të dëmtuarve nuk mund edhe të kërkojë ri mbursimin e çfarëdo shume të cilën nuk e ka paguar-kompensuar të dëmtuarve, për kundër faktit se aksidenti ka ndodhur me datën 31.07.2006. Padi në gjykatë është dorëzuar me datën 26.06.2015 ndërsa kompensimi i dëmit të dëmtuarve i është bërë me datën 25.03.2015, gjykata vlerëson se padija është paraqitur brenda afatit ligjor prej tri vite, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077, konkretisht nenit 357 paragrafi 1 të LMD-së ku është përcaktuar se *“kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vite, nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëmin”*. Me dispozitat e nenit 362 paragrafi 3 dhe 4 të LMD afatet e parashkrimit tek kontratat për sigurimin janë përcaktuar si në vijim: *“kërkesat e sigurvecit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tri vite”*, kurse me paragrafin 4 është paraparë se *“nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari ose shpërblimin e ka marrë prej tij parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj sigurvecit fillon nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar rrugë gjyqësore, shpërblimin nga i siguruari respektivisht kur i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin”* dhe Ligjit mbi sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë e njëjta është vërtetuar mbi bazën e konstatimit dhe mendimit të eksperteve të komunikacionit H. L. dhe N. D., raportit policor për aksidentin e datës 31.07.2006, ku është konstatuar se shkaktari i aksidentit është këtu i padituri B. B. dhe në momentin e aksidentit i njëjti ka qenë i pa siguarur dhe aktgjyqimeve të Gjykatës Komonale në Ferizaj C.nr. 584/06 ku me rastin e vendosjes për lartësinë e kompensimit gjykata ka pasur për bazë edhe kontributin e të dëmtuarit M. N. në aksident për çka edhe shumën e gjykuar e ka zvogëluar për shkallën e përgjegjësisë së tij në 10% për shkak të përgjegjësisë sekondare në këtë aksident. Vendimin lidhur me kamatën gjykata mori për bazë

nenin 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, në ndërkohë që edhe gjendja faktike në këtë procedurë është provuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit për shkeljet që i referohen dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së, pasi që dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 3, 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Meqenëse baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit nuk ka qenë kontestuese, përkatësisht e njëjta është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 584/06 të datës 14.02.2011 përmes të cilit aktgjykim, paditësja është obliguar t'ia kompensojë dëmin material dhe jo material të dëmtuarit M. N. për shkak të aksident të komunikacionit ku fajtor ka qenë i padituri. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 584/06 i datës 14.02.2011 është ekzekutuar përmes Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.325/2014 të datës 08.10.2014 nga përmbaruesi privat F.H. në Prishtinë, ndërsa përmes shkresës me numër 325/2024 të datës 25.03.2015 -urdhër transfer bankës, paditësja (B. K. e S.) i ka transferuar të dëmtuarit shumën prej 28.375.90 euro, rrjedhimisht edhe i krijohet e drejta për ri mbursim dëmi, sipas nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia nr. 04/L-018, ku është përcaktuar se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Lidhur me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht për pretendimet e paraqitura me ankesën e palës së paditur për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për shkak se gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe dispozitat e procedurës kontestimore janë aplikuar drejtë. Gjykata e Apelit, duke vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur thekson se nuk është kontestues fakti se aksidenti i

komunikacionit ka ndodh me datë 31.07.2006, ndërsa paditësja ka ushtruar padi për rimbursim dëmi ndaj të paditurit me datë 26.06.2015, mirëpo nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës së kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, andaj kjo gjykatë e pranon qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për arsyet si në vijim.

Sipas nenit 357 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077 parashihet se *“kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vite, nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëmin”*. Afatet e parashkrimit të kontratat për sigurimin janë përcaktuar me nenin 362 paragrafi 3 dhe 4 të LMD-së ku përcaktohet se *“kërkesat e sigurvecit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tri vite”*, kurse paragrafi 4 përcakton se *“nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari ose shpërblimin e ka marrë prej tij parashkrimi i kërkesës të të sigurvecit ndaj sigurvecit fillon nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar rrugë gjyqësore, shpërblimin nga i siguruari respektivisht kur i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin”*. Në këtë rast, paditësja me rastin e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit C.nr. 584/06 të datës 14.02.2011 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, sipas Urdhrit përmbarimor P.nr. 325/14 të datës 25.03.2015 i ka transferuar shumën e gjykuar të dëmtuarit, andaj nga momenti kur paditësja e ka ekzekutuar pagesën tek pala e dëmtuar, të njëjtës iu është krijuar e drejta për të kërkuar ri mbursim nga i padituri sipas nenit 18 paragrafi 4 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto- përgjegjësia Nr. 04/L-018, ku është përcaktuar se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, andaj edhe rrjedha e afatit të parashkrimit të drejtës për ri mbursim fillon nga ky moment, ngase kërkesa është bërë e arritshme sepse deri sa nuk ka paguar kurrfarë kompensimi të dëmtuarve nuk mund edhe të kërkojë ri mbursimin dhe vetëm pasi ka bërë pagesën e dëmit paditësja e ka kuptuar saktësisht shumën që do të duhej të ri mbursohej, prandaj kërkesëpadia e paditëses për ri mbursim dëmi nuk është e parashkruar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të të paditurës për sa i përket shumave të gjykuara me Aktgjykimin C.nr. 584/06 të datës 14.02.2011 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, konsideron se aktgjykimi i njëjtë është bërë i plotfuqishëm dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit CA.nr. 2404/12 të datës 06.08.2014 që do të thotë janë shfrytëzuar mjetet juridike dhe si pasojë e plotfuqishmërisë është nxjerr Urdhri përmbarimor P.nr. 325/14 me datë 25.03.2015, andaj i refuzon si të pa baza pretendimet e tilla ankimore.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 449 dhe 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore, ndërsa nuk qëndron pretendimi ankimor i palës së paditur se paditësja nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, ngase e njëjta i ka kërkuar

shpenzimet e procedurës me rastin e ushtrimit të paditë duke e cekur në petitumin e kërkesëpadisë se i kërkon shpenzimet e procedurës.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar si të drejtë dhe të rregullt vendimin e gjykatës së shkallës së parë në tërësinë e tij, ka ardhur në përfundim se ankesa e të paditurit është tërësisht e pabazuar, për çka edhe është vendosur që të njëjtën ta refuzoj.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3145/22, me datë 21.03.2024

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka**